



ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komora Farmaceuta Kosova
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 319 Dt. 07/07/21

KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS (OFK), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.1 dhe 1.14 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150, nenit 20, paragrafi 1 dhe 17 të Statutit të Odës së Farmacistëve të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 26/06/2021, nxjerr këtë :

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** raporti vjetor i punës së organeve të OFK-së për periudhen 1 Janar – 31 Dhjetor 2020
- II. Raporti i miratuar (57 faqe) i bashkangjitet këtij vendimi
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I'dërgohet:

- Shërbimit Profesional të OFK-së

Kryetari i OFK-së

Dr.sc. Arjanit Jakupi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komora Farmaceuta Kosova
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 219 Dt. 07/07/21



ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA

*RAPORT I PUNËS SË
ODËS E FARMACISTËVE TË KOSOVËS*

2020

Prishtinë



Përmbajtja

HYRJE	4
1. Raporti i punës së organeve të OFK-së	5
1.1 Kuvendi i OFK-së	5
1.1.1 Vendimarrjet me votim Qarkullues të Kuvendit.....	8
1.2 Këshilli Drejtues	8
1.3 Këshilli Mbikqyrës.....	17
1.4 Këshilli Etik.....	18
1.5 Prokurori	20
1.6. Komisionet e OFK-së	21
1.6.1. Anetaresimet, Licencimi dhe Rilicencimi.....	21
1.6.2. Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional	24
1.6.3. Komisioni për çështje etike.....	25
1.6.3. Komisioni për Edukim Specialistik	25
1.6.4. Komisioni për buxhet dhe financa.....	26
1.6.5. Komisioni për barnatore komunitare	27
1.6.6. Komisionit për caktimin e kushteve, kriterëve dhe përzgjedhjen e përfituesve të konkursit për përkrahjen financiare të punimeve shkencore të anëtarëve të OFK-së.....	28
1.6.7. Komisioni për provim Rilicencimi.....	29
2. ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE TE EDUKIMIT TE VAZHUESHËM PROFESIONAL NGA OFK	
30	
2.1 Menaxhimi i mbeturinave mjekësore farmaceutike në Kosovë”	30
2.2 “Farmacia në Kosovë dhe COVID 19”	31
2.3 . “Diabeti – sfidat në menaxhimin bashkëkohor”	33
2.4. Konkurs për përkrahje financiare të punimeve shkencore.....	34
2.OFK dhe COVID 19	34
3.1. Donacioni OFK-së për anëtarët e sajë – maska mbrojtëse	38
3.25 Shtatori (Dita Botërore e Farmacistit)	39
4. Të tjera	40
4.1. Anketa për unifikimin e çmimit të barnave	40



4.2.	Tryeza ““Ligji për paga dhe Papunësia në rradhët e profesionistëve shëndetësorë“”	41
4.3.	Takimi i përbashkët i OPSH me Ministrin e Shëndetësisë	42
4.4.	Kërkesa në MSH për hapjen e vendeve për specializim për profilet e farmacisë	43
4.5	Konferenca mbi shfuqizimin e UA për unifikimin e çmimit të barnave	44
4.5.	OFK pjesë e iniciativës për qirinjë në nderë të profesionistëve shëndetësor të cilët humbën jetën nga COVID 19	44
4.6.	Lobimi Dogana e Kosovës	45
4.7.	Reagimi publik ndaj kronikave mediale për kontrabandën e barnave	46
4.8.	Propozimet e OFK-së për plotësim ndryshimin e UA-11/15 për qarkulluesit me pakicë të produkteve farmaceutike	47



HYRJE

I nderuari Ministër ,

Ky raport paraqet një pasqyrim të punës dhe aktiviteteve të organeve të OFK-së për periudhen raportuese Janar - Dhjetor 2020.

Raporti përmban një përshkrim të aktiviteteve dhe shërbimeve të OFK-së gjatë periudhes raportuese

Ky raport është i përshkruar në 57 faqe.

Aktivitetet e paraqitura në raport janë ilustruar me nga një apo më shumë foto representative, dhe të dhënat e ofruar janë paraqitur në diagrame.

Raportet vjetore të punës së OFK-së do të publikohen në Web- faqen e Odës së Farmacistëve të të Kosovës, pasi të miratohen nga Kuvendi i OFK-së.



Arjanit Jakupi

Kryetar i OFK-së





1. Raporti i punës së organeve të OFK-së

Në periudhen raportuese kishte vazhimesi të procesit të punës nga ana e organeve të Odës së Farmacistëve të Kosovës, të cilat për shkaqe të pandemisë u mbajtën në formë të kombinuar, fizike dhe takime online

Në këtë periudhe takime kanë mbajtur :

1.1 Kuvendi i OFK-së

Gjatë vitit 2020, Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës ka mbajtur dy (2) takime, duke mbajtur kontakte të vazhdueshme dhe nxjerr vendime edhe me votim qarkullues nëpërmjet email adresave

Takimi 06/08/2020 - Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës shqyrtoi veprimet e mëtutjeshme pas vendimit të Ministrit të Shëndetësisë për Shfuqizimin e Udhëzimit Administrativ për unifikimin e çmimit të barnave. Në këtë Kuvend, në mënyrë unanime u miratua kjo deklaratë publike për adresim në Kuvendin e Kosovës, Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Ministrinë e Shëndetësisë. :

- I. Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës mirëpret anulimin e vendimit për shfuqizimin e udhëzimit administrative 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale.
- II. Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës konfirmon qëndrimin e deritanishëm të organeve të saj për vazhdimin e procesit të unifikimit të çmimit të barnave aty ku është pezulluar ky proces.
- III. Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës zotohet se përfaqësuesit e organeve të OFK-së do të marrin pjesë në plotësimin dhe ndryshimin e këtij udhëzimi por me kushtin që fillimisht të vazhdojë procesi, të zbatohen çmimet dhe të fillojë shtypja e banderolave me çmime. Kjo ishte e paraparë edhe nga ekspertët botërorë që kanë qenë konsulentë të hartimit të këtij udhëzimi se procesi gjatë viteve duhet të plotësohet-ndryshohet, por jo pa u zbatuar ky proces që tashmë është në fazën finale.
- IV. Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës fton Ministrinë e Shëndetësisë që brenda afatit të arsyeshëm të nxjerrë vendim për emërimin e komisionit të ankesave, kryesuesin e komisionit për çmimin e barnave dhe emërimin e anëtarit të deleguar të OFK në komisionin



për çmimin e barnave ashtu siç është përcaktuar me udhëzimin 02/2019 dhe të merren masa nga MSH që të vazhdojë puna për finalizimin e këtij procesi.

- V. Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës fton Minsitrinë së Shëndetësisë dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës që të bëjë bartjen e kompetencave të parapara me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë.
- VI. Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës fton Qeverinë e Republikës së Kosovës, që të trajtojë në mënyrë të barabartë komunitetin farmaceutik me profesionet tjera shëndetësore përfshirë ato specialistike dhe gjithashtu në kuadër të masave të pakos fiskale dhe pakos së rimëkëmbjes ekonomike.
- VII. Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës shpreh gadishmërinë e anëtarëve të OFK-së për ndihmë Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë për çdo çështje profesionale të domenit të farmacisë e posaçërisht tani në përballje me COVID 19.




Takimi 26/12/2020 –Kuvend në respektim të masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtje nga pandemia COVID 19 është organizuar online përmes platformës zoom., pas diskutimeve nga anëtarët u miratua raporti financiar, plani i punës për vitin 2021 i cili parasheh më shumë aktivitete përmes të cilave synojmë lehtësime në procesin e edukimit të vazhdueshëm profesional dhe stimulimin e



anëtarëve tonë për hulumtime shkencore. Po ashtu disa nga aktet aktuale ju nënshtruan procesit të plotësimit - ndryshimit të tyre në përputhje me propozimet e organeve të OFK-të.

Në Kuvend ndër të tjera u vendos:

- Të gjithë anëtarët e OFK-së që arrijnë moshën 65 vjecare në shenjë mirënjohje përfitojnë statusin e anëtarit të nderit të OFK-së për kontribut jetësor në sektorin farmaceutik. Këta anëtarë lirohen nga pagesa e anëtarësimit apo edhe taksave tjera administrative për shërbimet në OFK-së.
- Kalimi nga shërbimet fizike në shërbimet online për anëtarët si një nga pikat e rëndësishme të cilat besojmë se do të kontribuojë në masë të madhe në lehtësimin dhe avansimin e shërbimeve tona.
- Dyfishim i buxhetit për përkrahjen profesionale – shkencore.
- Leje për hulumtime shkencore-profesionale të anëtarëve të OFK-së pa taksë administrative.
- Lehtësira fianciare në kuadër të solidaritetit për anëtarët me vështirësi ekonomike.
- Të paktën dy aktivitetet të edukimit të vazhdueshëm gjatë vititit 2021
- Aprovimi i rregulloreve të cilat kanë munguar duke plotësuar kështu kuadrin ligjor të OFK-së.
- Aprovimi për mundësinë e dhënies së faksimilit me tituj shkencorë etj.





1.1.1 Vendimarrjet me votim Qarkullues të Kuvendit

Gjatë muajit Tetor Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës ka nxjerr dy vendime përmes votimit qarkullues me anë të email adresave dhe atë si më poshtë :

- Vendimi i kuvendit nr. 30 i datës 05/05/2020 për barazvlerësimin e aktiviteteve të EVP-së të cilat mbahen online me pikët e përcaktuar për aktivitetet profesionale të cilat mbahen me prani fizike të pjesëmarrësve
- Vendimin nr. 78 me të cilin është vendosur që Taksa administrative e paraparë në vendimin nr.42 të Kuvendit gjatë vitit 2019 prej 5 Euro për mospërmbajtje të afatit për anëtarësim të mos zbatohet për vitin 2020. Sipas këtij vendimi të gjithë anëtarët të cilët kanë paguar këtë taksë shtesë gjatë vitit 2020, pagesa i njihet si parapagim për anëtarësim 2021, dhe rifillimin e kësaj takes gjatë vitit 2021. Ky vendim erdhi nën arsyetimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID 19.
- Vendimin nr. 79 me të cilin është vazhduar vendimi i kuvendit nr. 30 i datës 05/05/2020 për barazvlerësimin e aktiviteteve të EVP-së të cilat mbahen online me pikët e përcaktuar për aktivitetet profesionale të cilat mbahen me prani fizike të pjesëmarrësve

1.2 Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues në periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2020, ka mbajtur 26 takime. Në takime janë shqyrtuar tematika të ndryshme të përshkruara si në tabelën e mëposhtme

KËSHILLI DREJTUES	
JANAR – DHJETOR 2020	
Mbledhja	SHQYRTIMET – TEMATIKA
Nr	
Datë	



1/20	13/01/2020	<ol style="list-style-type: none">I. Miratimi i rregullorës për shërbim profesionalII. Pregaditjet për organizim simpoziumit për diabetIII. Përcaktimi i temave për trajtm në aktivitetin Asgjësimi i BarnaveIV. Aprovimi i kërkesës së anëtarës Arbnora Beka për shpërndarje pytësori për temë masterV. Caktimi i të deleguarit të OFK-së në takimin PGEU
2/20	23/01/2020	<ol style="list-style-type: none">I. U përcaktua që punëtorja për Asgjësimin e Barnave të mbahet në tri qendra rajonale Prishtinë, Prizren dhe GjilanII. U përcaktuan anëtarët e këshillit shkencorë dhe atij organizativ për simpoziumin DiabetiIII. Refuzimi i kërkesës për shqyrtimi i kërkesës së anëtarëve të KNJZ-së Pejë për organizimin e zgjedhjeve në OFK për vitin 2014
3/20	07/02/2020	<ol style="list-style-type: none">I. Në përputhje me rregullorën për EVP nr.22 të datës 29.06.2019 rekomandoi komisionit për EVP shqyrtimin e aplikacionit nga Shiqata e Farmacistëve të Kosovës për akreditimin e punëtorisë “Gripi dhe Ftohja”II. Kërkesa nga AQH u refuzuaIII. Propozuan disa ndryshime për rregulloren e EVP-seIV. Kontrata me zyrtarin për kontabiletet për 2020
4/20	20/02/2020	<ol style="list-style-type: none">I. U aprovua kërkesa për kompenzimin e studenteve të angazhuar në Kongresin 2019II. Ligjëruesit në punëtorinë mbi asgjësimin e barnave për shkak të shpërndarjes së ligjëratave në tri rajone u vendos të komenzohen sipas programeve të rilicencimit



5/20	27/02/2020	<p>I. U shqyrtuan pregaditjet për organizimin e simpoziumit</p> <p>II. Këshilli Drejtues vendos që në gjitha takimet ku kërkohet përfaqësim i OFK-së, të përfaqësohet nga Kryetari i OFK-së sipas funksionit ligjorë. Në rast përfaqësimi të anëtarit tjetër, anëtari të caktohet në bashkupim me Këshillin Drejtues.</p>
6/20	10/03/2020	<p>I. Për shkak të situatës me COVID 19, Këshilli Drejtues vendos pezullimin e këtij aktiviteti deri në krijimin e kushteve për mbajtjen e tijë.</p> <p>II. Autorizimi i kryetarit të OFK-se dhe Kryetarit të Komisionit për Barnatore Komunitare për hartimin e kumtesës drejtuar farmacisë komunitare për mbrojtje nga COVID 19</p>
7/20	27/03/2020	<p>I. Situata me COVID 19 në farmaci</p> <p>II. Miratimi I rekomandimeve për Ministri të Shëndetësisë për masat mbrojtëse në farmaci duke përfshirë rekomandet si :</p> <ul style="list-style-type: none">• Rekomandimi për shkurtimin e orarit të punës në barnatore• Orari i punës ekipore dhe mënyra e organizimit të punës së barnatoreve• Gjendja e gadishmërisë <p>III. Komunikata e përbashkët OFK, Komitetit për koordinimin dhe vlerësimin e situatës epidimologjike dhe AKPPM</p>
8/20	30/03/2020	<p>I. Diskutimi për organizimin e kujdestarive pas vendimi të MSH-së nr 02/17 të datës 27 Mars 2020 dhe kërkesat e farmacistëve në këtë proces me masat mbrojtëse</p>



9/20	31/03/2020	I. Situata me COVID 19 II. Aproximin e hulumtimit rreth situatës me COVID 19, përkatësisht rreth përvojës së farmacistëve dhe studimin e masave të ndërmarra në këtë periudhë
10/20	22/04/2020	I. Rasti infektimit të farmacistit të parë II. Donacioni për OFK me face shield nga Bonevet III. Organizimi i aktiviteteve të EVP-së falas për 20 pikët e nevojshme për rilicencim për vitin 2020 organizimi i ërbbinarit
11/20	28/05/2020	I. Miratohet raporti financiar për vitin 2019 II. Kërkesa në Ministrinë e Financave për ndihmën e farmacistëve në pakon fiskale III. Fushata e ndërmarrë nga palët e interesit rreth UA për çmimet e barnave
12/20	09/06/2020	I. Ua për çmimet pas dorëheqjes së komisionit të ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë II. Takimi i Odave të Profesionistëve Shëndetësor me Kryeministrinë e Kosovës
13/20	12/06/2020	I. Unifikimi i çmimit të barnave – caktimi i përfaqësuesit në Komisioni Arianit Jakupi II. Anketa-Referendum me farmacistë ku do të deklarohen të gjithë për vullnetin e tyre për unifikimin dhe për qështjet tjera që do të vendosim bashkarisht
14/20	18/06/2020	I. Takimi me Shoqatën e Distributorëve për të shqyrtuar dilemat e tyre rreth UA për unifikimin e çmimit të barnave II. Shqetësimet e komunitetit me respektimin e masave COVID 19



15/20	26/06/2020	<p>I. Takimi i Odave të Profesionistëve Shëndetësor me Ministrinë e Shëndetësisë - njoftuar në lidhje me qëndrimin e OFK-së për sa i përket procesit të unifikimit të cmimit të barnave</p> <p>II. Miratimi i draft raportit të OFK-së për zgjidhjen e “dilemave të ngritura nga dorëheqja e komisionit të ankesave të MSH-së për çmimet e barnave, dhe dërgimi i tij në MSH</p> <p>III. Kërkesa e anetares Mimoza Pira për shpërndarje të pyetësorit për qëllime të studimeve të doktorates lidhur me ndikimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në vendin e punës.</p>
16/20	24/07/2020	<p>I. vizitat e shumët dhe pa masa mbrojtëse të pacienteve të cilat kërkojnë terapi tipike për COVID 19.</p> <p>II. Mos përgjigja nga ana e Minsitrisë së Shëndetësisë në raport me Udhëzimin 2/2019 për cmimet e barnave dhe rekomandimet e OFK-së të dërguara me shkrim për zgjidhjen e situatës dhe pretendimet e anëtarëve të komisionit të ankesave.</p> <p>III. Shkollimi specialistik- refuzimi ministrit për nënshkrimin e udhëzimit të ri specialistik si dhe informata jo-zyrtare mos përfshirje në konkurs të farmacistëve</p> <p>IV. Kërkesa për konstatimin e paligjshmërisë të UA aktual për specializim dhe mosreflektimi i MSH</p> <p>V. Delegimet në grupe punuese</p> <p>VI. Koncept dokumenti për trajtimin e COVID 19 – Sabrije Fazliu</p> <p>VII. Koncept dokumenti i ligjit për shëndetësi dhe ligji për inspektoriat – Dardane Mehaj</p>



		VIII. Koncept dokumenti për ligjin për sigurime shëndetësore – Astrit Iljazi
17/20	05/08/2020	<p>I. Shfuqizimi i Udhëzimit Administrativ nr.02/2019 për rregullimin e cmimeve dhe produkteve medicinale nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë</p> <p>II. Konferencë mbi qëndrimin e OFK-së</p> <p>III. Ankesat mbi pavlefshmërinë juridike të vendimit për shfuqizim në Qeverinë e Kosovës</p> <p>IV. Kuvendi i jashtëzakonshëm online të Kuvendit të OFK-së për datën 06/08/2020</p>
18/20	08/09/2020	<p>I. Opinioni i zyrës ligjore të Kryeministrit për UA 5/2017 për specializime)</p> <p>II. Të deleguarit :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Florina Berisha - Plotësim ndryshimi i UA nr.01/15 për Autorizim Marketing të Produkteve Medicinale • Nazif Qazimi – Plotësim ndryshimi i UA nr. 13/2013 për Qarkulluesit Farmaceutik me shumicë • Visar Ademi – plotësim ndryshimi i UA nr.11/2015 për Qarkulluesit me pakicë të produkteve dhe paisjeve medicinale • Sabrije Fazliu – plotësim ndryshimi i UA nr.04/2016 për tarifatat e shërbimeve të ofruara nga AKPM



19/20	15/09/2020	<p>I. Organzimi i ditës botërore të farmacisë</p> <p>II. Miratimi i raporteve të punës të organeve të OFK-së për periudhën Janar – Qershorë 2020</p> <p>III. Zëvendësim në komisionin për provim të rilicencimit Arianit Jakupi zëvendësohet nga Rozafa Koliqi</p> <p>IV. Njoftimi për rrjedhën e projektligjit për shëndetësi nga e deleguara Dardane Mehaj</p> <p>V. Shqetësimet e të deleguarës Sabrije Fazliu për punën e grupit për hartimin e UA për tarifa në AKPPM</p> <p>VI. Miratimi hulumtimit për përdorim të antibiotikëve</p>
20/20	02/10/2020	<p>I. Rishqyrtimi i taksës prej 5 Euro për muajt vonesë - Këshilli Drejtues vendos që ti propozojë Kuvendit të vendos moszbatimin e taksës prej 5 Euro për vitin 2020 dhe propozimin për aktivitetet e EVP-së</p> <p>II. Legjislacioni raportimi nga të deleguarit Agon Hoti- Ligjin për Produktet dhe Paisjet Medicinale Dardane Mehaj – Ligji për Shëndetësi Astrit Iljazi – Sigurimet Shëndetësore</p>
21/20	12/10/2020	<p>I. Ndryshimi i legjislacionit – Raportimi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Visar Ademi në cilësin e të deleguarit në plotësim ndryshim të UA 11/15 raporton për punën e grupit punues • Sabrije Fazliu raporton për ndryshimet e draftit final në UA për cmime <p>II. Rishikimi i vendimit për afatin kohorë të taksave administrative për vitin 2018 dhe 2019 me vendimin e Kuvendit për afatin me 31 Qershorë</p>



22/20	16/10/2020	<ol style="list-style-type: none">I. Këshilli Drejtues unanimisht vendosi që propozimet e e dala nga takimi të dërgohen me shkrim si propozime të OFK-së.II. Raportimi dhe komentet për projektligjin për ShëndetësiIII. Autorizimi i KEVP-së për shqyrtimin e aplikacionit të UBT për akreditim
23/20	20/11/2020	<ol style="list-style-type: none">I. Gjendja në sektorin farmaceutik- reagimi OFK-së në raport me kronikat mediale për ndryshim çmimeshII. Raportimi i te deleguarveIII. Dergimi i komente per UA per barnatore ne konsultime publikeIV. Organizimi i Simpoziumit DiabetiV. Autorizimi i aktivitetit Exclusive shpkVI. Emërimi i Sekretarit të OFK-së si person përgjegjës për komunikim me inspektoriat në kuptim të memorandumit të bashkëpunimit
24/20	04/12/2020	<ol style="list-style-type: none">I. Mbarëvajtja e simpoziumitII. Rrjedha organizimit të simpoziumitIII. Oblisku i profesionistëve shëndetësor në kujtim të të vedekurve nga COVID 19
25/20	11/12/2020	<ol style="list-style-type: none">I. Raporti mbi mbarvajtjen e simpoziumit DiabetiII. Propozimi i draft buxhetit 2021III. Propoziet e rregullores për fushëveprim të komisionit etik dhe komisionit për farmaci spitalore



26/20	17/12/2020	<p>IV. U propozuan për Kuvend miratimi i :</p> <ul style="list-style-type: none">• Rregullorja e komisionit për çështje etik• Rregullorja e komisionit për farmaci spitalore• Rregullorja e komisionit për solidaritet dhe ndihme reciproke• Plotësim ndryshimi i rregullorës për procedurat dhe kriteret e anëtarësimit në OFK• Plotësim ndryshimi i rregullorës për licencimin dhe rilicencimin e farmacistëve• Plotësim ndryshimi i rregullorës për edukimin e vazhdueshëm profesional• Plotësim ndryshimi i vendimit për taksa• Programi punës 2021 <p>I. U vendos përpërja e komisionit për konkursin për përkrahje financiare të punimeve shkencore në përbërje prej</p> <ul style="list-style-type: none">• Armond Daci – Kryesues• Arlinda Daka Grapci – Anëtare• Driton Shabani – Anëtarë <p>II. U vendos bordi (komisioni) editorial i revistës profesionale në përbërje prej :</p> <ul style="list-style-type: none">• Arianit Jakupi – Kryesues• Lul Raka – Anëtarë• Shaip Krasniqi – Anëtarë• Pranvera Breznica – Anëtare• Rozafa Koliqi – Anëtare• Kreshnik Hoti – Anëtarë
-------	------------	--



1.3 Këshilli Mbikqyrës

Gjatë vitit 2020, Këshilli Mbikqyrës i OFK-së ka mbajtur gjithsejt tetë (8) mbledhje, në të cilat u shqyrtuan raportet paraprake mujore të punës, të të hyrave dhe kostove të mbledhjeve të disa organeve të OFK-së, të pranuar nga shërbimi profesional i OFK-së:

1. Në mbledhjen e mbajtur me datë 16.01.2020, Këshilli Mbikqyrës shqyrtoi dhe aprovoi, pa ndonjë vërejtje, raportet e pranuar për muajin Dhjetor 2019.
2. Në mbledhjen e mbajtur me datë 26.02.2020, Këshilli Mbikqyrës shqyrtoi dhe aprovoi, pa ndonjë vërejtje, raportet e pranuar për muajin Janar 2020.
3. Në mbledhjen e mbajtur me datë 21.05.2020, Këshilli Mbikqyrës shqyrtoi dhe aprovoi, pa ndonjë vërejtje, raportet e pranuar për muajt Shkurt, Mars dhe Prill 2020. Në këtë mbledhje, Këshilli Mbikqyrës, si organ mbikqyrës i buxhetit dhe financave të OFK-së dha edhe një mendim rreth propozimit të anëtares së Kuvendit Nora Rrahimi për lirim nga pagesa për anëtarësim në OFK, për të gjithë farmacistët, për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia Covid-19.
4. Në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2020, Këshilli Mbikqyrës, shqyrtoi dhe aprovoi, pa ndonjë vërejtje, raportet e pranuar për muajin Maj 2020.
5. Në mbledhjen e mbajtur me datë 18.08.2020, Këshilli Mbikqyrës, shqyrtoi dhe aprovoi pa vërejtje raportet e punës të organeve të OFK-së për muajt Qershor dhe Korrik 2020.
6. Në mbledhjen e mbajtur me datë 30.10..2020, Këshilli Mbikqyrës, shqyrtoi dhe aprovoi pa vërejtje, raportet e punës të organeve të OFK-së për muajt Gusht dhe Shtator 2020.
7. Në mbledhjen e mbajtur me datë 26.11.2020, Këshilli Mbikqyrës, shqyrtoi dhe aprovoi me një vërejtje për gabim teknik në raport, raportet e punës të organeve të OFK-së të muajit Tetor 2020. Në këtë mbledhje, Këshilli Mbikqyrës poashtu miratoi planin e punës dhe shpenzimeve të Këshillit Mbikqyrës për vitin 2021, plan ky që iu dërgua Këshillit Drejtues të OFK-së.
8. Në mbledhjen e mbajtur me datë 22.12.2020, Këshilli Mbikqyrës, shqyrtoi dhe aprovoi me disa vërejtje teknike, raportet e punës të organeve të OFK-së për muajin Nëntor 2020, dhe miratoi këtë Raport të punës së Këshillit Mbikqyrës të OFK-së për vitin 2020.



1.4 Këshilli Etik


Këshilli Etik në periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2020, ka mbajtur 6 takime. Në takime janë shqyrtuar tematika të ndryshme të përshkruara si në tabelën e mëposhtme

Nr	Datë	
1/20	24/02/2020	Realizimi i planit të punës për vitin 2020, në të cilin do të përfshihej spot informues mbi rolin e farmacistit dhe prezencën e tij në barnatore , takimet me Këshillat Etik të Odave tjera dhe ato rajonale
2/20	05/04/2020	Shqyrtimi i propozim ankesës së prokurorit të OFK-së të datës 16/03/2020, konstatimi se ekziston dyshimi i bazuar për shkelje etike dhe ftesa e farmacistit përgjegjës për deklaram në seancën e shqyrtimit kryesorë pranë Këshillit Etik
3/20	18/05/2020	Miratimi i vendimit shfajësues të farmacistës ndaj të cilës është iniciuar procedura ne baze te provave te mbledhura dhe rregullores per percaktimin e masave dhe pergjegjesise disiplinore pas u konstatua se farmacistja ndaj të cilës është zhvilluar procedura ka hequr dorë nga funksioni si farmaciste përgjegjëse para se të ketë ndodhur rasti.
4/20	12/10/2020	U shqyrtua nevoja për hartimin e një qarkore informative në lidhje me legjislacionin aktual pëkitazi me shkeljet etike të farmacistëve dhe masat disiplinore me rastin e konstatimit të tyre si dhe nevojën mbi arritjen e memorandumeve bashkëpunuese me Oda e Profesionistëve Shëndetësor
5/20	09/12/2020	Pas konstatimit se ekziston dyshimi i bazuar për shkelje etik në rastin e iniciuar nga Prokurori i OFK-së dhe miratimit të raportit të relatorit me votim qarkullues email, Këshilli Etik ka mbajtu seancën e shqyrtimit kryesor dhe dëgjimi, ku të pranishëm në seancë ishin të gjitha palë e parapara në legjislacionin përkatës



6/20	18/12/2020	Organizimi i seancës së shqyrtimit dhe votimit. Pas shqyrtimit të provave të lëndës, deklarates së pjesëmarrësve në procedurë, Keshilli Etik vendosi të pranojë deklaratën e fajtesisë nga ana e farmacistit. Duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese të percaktuara me rregulloret të cilat janë përmbushur nga ana e farmacistit, Keshilli Etik vendosi shqiptimin e masës minimale të percaktuar në rregulloren dhe Ligjin e Odave të Profesionistëve Shëndetësor - Denim me të holla 1000 Euro me pagesë me kete për 10 muaj duke e përfshirë në kete shumë edhe shpenzimet procedurale
------	------------	--

Keshili Etik në numra






1.5 Prokurori

Prokurori i OFK-së në periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2020, ka mbajtur 5 takime. Në takime janë shqyrtuar tematika të ndryshme të përshkruara si në tabelën e mëposhtme

Mbledhja		SHQYRTIMET – TEMATIKA
Nr	Datë	
1/20	16/03/2020	Shqyrtimi dhe analizimi i denoncimit publik të Komunës së Skenderajit, mbi punën e farmacistit në barnatore në të cilin I'u propozua Këshillit Etik, mbajtja e seancës kryesore dhe shqiptimi i masës disiplinore konform legjislacionit përkatës ndaj farmacistit përgjegjës
2/20	10/04/2020	Informimi nga Kryetari OFK-së për takimin e zhvilluar me Kryeinspektorin farmaceutik në lidhje me zbatimin e memorandumit të bashkëpunimit OFK-IF. Në takim u diskutua edhe mbi raportimet mediale mbi vepra recidiviste të subjekteve farmaceutike për të cilat u dakordua që sipas memorandumit do të analizohen për përgjegjësi etike të farmacistit vetëm pas inicimit dhe pranimit të dosejes së lëndës nga ana e Inspektoriatit Farmaceutik
3/20	15/09/2020	Ne takimin e mbajtur, prokurori dhe zv. Prokurori pas analizes se bere shkresave se lendes, konstatuan se ekziston dyshimi i arsyeshëm për shkelje etik. Telefonuan famracistin pergjegjes i cili konfirmoje se ka pranuar kerkesen e Prokurorit dhe shume shpejt do ti dergoje dokumentet e kerkuar nga ana e tyre.
4/20	30/09/2020	Shqyrtimi i ankesës e pranuar nga pala e dëmtuar dhe shqyrtimi i dokumentacionit të ofruar nga farmacisti përgjegjës sipas kërkesave të zhvilluara me email
5/20	13/10/2020	Prokuroi dhe zv. Prokurori i OFK-se, pas shqyrtimit te te gjithë dokumentacionit te ofruar nga te dyja palet, vendosen se ekziston dyshimi i bazuar se ne rastin e paraqitur ka thyerje te rregullave te percaktuara nga Kodi Etik. Per kete vendosen qe propozim ankesen te drejtojne ne Keshill Etik pas hartimit dhe miratimit te saj me emai



1.6. Komisionet e OFK-së

Në periudhën raportuese, janë mbajtur takime nga ana e komisionit për


- Komisioni për çështje etike;
- Komisioni për licencim të profesionistëve shëndetësor;
- Komisioni për edukim specialistik;
- Komisioni për edukim të vazhdueshëm profesional;
- Komisioni për buxhet dhe financa;
- Komisioni i solidaritetit dhe ndihmës reciproke.
- Komisioni për barnatore komunitare
- Komisionit për caktimin e kushteve, kriterëve dhe përzgjedhjen e përfituesve të konkursit për përkrahjen financiare të punimeve shkencore të anëtarëve të OFK-së
- Komisioni për provim Rilicencimi

1.6.1. Anetaresimet, Licencimi dhe Rilicencimi

Komisioni për Licencim i Odës së Farmacistëve të Kosovës në periudhën raportuese ka mbajtur 24 takime nga të cilat 3 janë mbajtur në mënyrë elektronike për shkak të masave të mbrojtjes nga COVID 19 të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë.



Gjatë periudhës raportuese, Komisioni ka aprovuar 112 kërkesa për anëtarësim, 66 kërkesa për licencim dhe 53 kërkesa për rilicencim.



Gjatë kësaj kohe komisioni për licencim ka propozuar tek Këshillin Drejtues plotësim-ndryshimin e rregullorë për procedurat dhe kriteret e anëtarësimit si dhe rregullorën për licencim.

Ndryshimet e propozuar, së bashku me ndryshimet e Këshillit Drejtues janë miratuar nga Kuvendi i OFK-së me datë 26/12/2020.

Ndryshimet e miratuara në rregullorën për licencim dhe rilicencim :

“ Neni 8A

Rilicencimi i farmacistëve të cilët pezullojnë ushtrimin e veprimtarisë

1. Farmacistët e rilicencuar të cilët në mënyrë vullnetare heqin dorë nga ushtrimi i veprimtarisë profesionale para skadimit të licencës së tyre, me rastin e rilicencimit i nënshtrohen provimit për rilicencim në kuadër të OFK-së.
2. Farmacistët të cilët pas skadimit të licencës së tyre, nuk i janë nënshtruar procesit të rilicencimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) e më shumë viteve, me rastin e rilicencimit i nënshtrohen provimit për rilicencim në kuadër të OFK-së.
3. Farmacistët nga paragrafi 1 dhe 2 konsiderohen se kanë 0 pikë kredituese nga EVP
4. Farmacistët nga paragrafet paragrafe vlerësohen në përputhje me nenin 8 të rregullorës “



- I. Reformulohet përmbajtja e paragrafit 8 dhe 9 të nënit nenit 14 sipas përmbajtjes së mëposhtme :

“8. Faksimili ka këtë përmbajtje :

8.1 Llogo zyrtare e OFK-së

8.2. Thirrjen akademike dhe shkencore

8.3 Emrin dhe Mbiemrin

8.4 Thirrjen Profesionale për të cilën është licencuar

8.5 Numrin e Licencës.

8.6 Numri i anetaresise

Ndryshimet në rregulloren për procedurat dhe kriteret e anëtarësimit :

- I. Pas nenit 5 të Rregullorës shtohet nen i ri me përmbajtjen

“ Neni 5 A

Anëtarët nderi të OFK-së

1. Të gjithë anëtarët e OFK-së që arrijnë moshën 65 vjecare në shenjë mirënjohje përfitojnë statusin e anëtarit të nderit për kontribut jetësor në sektorin farmaceutik të OFK-së
2. Personat me kontribut të vecantë në sektorin farmaceutik me propozimin e Këshillit Drejtues dhe miratimin e Kuvendit të OFK-së fitojnë statusin mirënjohës të anëtarit të nderit për merita të vecanta në sektorin farmaceutik të Kosovës
3. Anëtarët e nderit për kontribut jetësor në sektorin farmaceutik janë të liruara nga të gjitha pagesat e taksave administrative për shërbimet e OFK-së.
4. Statusi i anëtarit të nderit për merita të vecanta në sektorin farmaceutik të Kosovës nuk krijon të drejta dhe obligime në raporte të ndërsjellta me OFK-në.
5. OFK me përmbushjen e kriterëve të parapara nga paragrafi I dhe II I këtij neni, lëshon certifikatë mbi statusin e anëtarit.



1.6.2. Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Në periudhen 01.01.2020 – 31.12.2020 janë mbajtur dymbëdhjetë mbledhje të Komisionit për EVP.

Në këtë periudhë:

1. Janë akredituar 9 aktivitete të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional:


- a) Simpoziumi “Menaxhimi i mbeturinave mjekësore – farmaceutike në Kosovë” - Oda e Farmacistëve të Kosoves dhe Inspektoriati Farmaceutik
- b) Kurs i kategorise se dytë (II) - “Gripi dhe ftohja” – Shoqata Farmaceutike e Kosovës
- c) Simpoziumi Ndërkombëtar - “Diabeti –Sfidat ne menaxhimin bashkëkohor” - Oda e Farmacistëve të Kosoves
- d) Ëëbinari - **Farmacia ne Kosove dhe Covid-19** - Oda e Farmacistëve të Kosoves
- e) Kurs i kategorise se dytë (II) “Gyn Oncology up to date” - Klinika Gjinekologjike Gjermane
- f) Kërkesa e KSHQS AQH pas shqyrtimit është cilësuar si aplikim jashtë afatit kohor
- g) Kurs online CFO Pharma “*Improve your sales in Pharmacy*”
- k) Konferenca UBT **International Conference on Pharmaceutical and Natural Sciences 2020**
- l) Kurs Exklusiv Shpk – **Preparatet bimore dhe ndikimi i tyre ne farmaci**

2. Janë valorizuar pikët për rilicencim për 34 anëtarë të OFK-së:

3. Kërkesa drejtuar KD/Kuvendit të OFK-së

KEVP në mbledhjen e mbajtur me datë 04.05.2020, duke pas parasysh situatën e krijuar me Covid-19, propozoj që t’i drejtohet anëtarëve të Kuvendit të OFK me kërkesë për barazvlerësimin e pikëve të takimeve të mbajtura online me aktivitetet profesionale që mbahen me prezenc fizike të farmacistëve (Konferenca, Kongrese, Simpozium etj). Ky barazvlerësim të zgjatë për periudhën sa zgjatë pandeminë

KEVP ka propozuar KD të OFK që gjatë muajit Nentor 2020 të mbajë një Ëëbinar me pjesëmarrje më të madhe, me qëllim të plotësimit të pikëve minimale të EVP për të gjithë anëtarët e OFK.



1.6.3. Komisioni për çështje etike

Komisioni për Çështje Etik i OFK-së në periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2020, ka mbajtur 1 takim. Në takime janë shqyrtuar tematika të përshkruara si në tabelën e mëposhtme

Nr	Datë	
1/20	08/12/2020	Hartimi i draft rregullores për përcaktimin e fushveprimit të komisionit për çështje etike dhe dërgimi i këtij drafti në Këshillin Drejtues.

1.6.3. Komisioni për Edukim Specialistik

Komisioni për edukim specialistik i OFK-së vepron mbi bazën e një rregullative ligjore të vjetër e cila është qysh para themelimit të Odave profesionale shëndetësore, rregullativë e cila nuk është kompatible me kompetencat e Odave në përgjithësi dhe me kompetencat e Komisioni për edukim specialistik të OFK-së në veçanti. Megjithë tentativat tona (por edhe të Odave tjera shëndetësore) për të bërë ndryshimet e nevojshme në UA për Edukim Specialistik, nuk kemi gjetur përkrahje nga Ministria e Shëndetësisë.

Mbi bazën e tanishme ligjore, Komisioni për edukim specialistik i OFK-së e ka pothuajse të pamundur të veprojë sepse ka hapësirë shumë të ngushtë veprimi.

Komisioni për edukim specialistik i OFK-së në periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2020, ka mbajtur 1 takim. Në takim janë shqyrtuar tematika të përshkruara si në tabelën e mëposhtme.



Mbledhja		SHQYRTIMET – TEMATIKA
Nr	Datë	
1/20	14/07/2020	<p>Në këtë takim kryetari i Komisionit njoftoi anëtarët në lidhje me themelimin e ri të Bordit Qëndror për Shkollim Specialistik. Kryetari Emiri së bashku me anëtarët prezent hartuan edhe shkresën e cila i është dërguar Bordit Qendror për Shkollim Specialistik në të cilin paraqitën zotimin e Komisionit për Shkollim Specialistik të OFK-së për të kontribuar në Bord me këtë rast u kërkua që të paktën një anëtar i t'i ofrohet mundësia e pjesëmarrjes në takimet e Bordit në mënyrë OFK të këtë munësinë që të adresojë kërkesat e veta në këtë Bord të rëndësishëm për edukim specialistik.</p> <p>Deri më tani nuk kemi marrë përgjigje nga BQSHS edhe pse aty nuk ka asnjë përfaqësues nga OFK</p>

1.6.4. Komisioni për buxhet dhe financa

Komisioni për buxhet dhe financa në periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2020, ka mbajtur 2 takime. Në takime janë shqyrtuar tematika të ndryshme të përshkruara si në tabelën e mëposhtme

Nr	Datë	
1/20	28/02/2020	<p>Planifikimi buxhetor për organizimin e simpoziumit “Diabeti, Sfidat e Menaxhimit Bashkëkohor”</p> <p>Propozimi mbi kompenzimin e ligjëruesve në kuadër të puntorisë mbi Menaxhimin e mbeturinave</p>
2/20	1/12/2020	Hartimi i draft buxhetit të OFK-së për vitin 2021, dërgimi për miratim në Këshill Drejtues dhe aprovim nga Kuvendi



1.6.5. Komisioni per barnatore komunitare

Komisioni për Barnatore Komunitare në periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2020, ka mbajtur 1 takim. Në takime janë shqyrtuar tematika të përshkruara si në tabelën e mëposhtme

JANAR – DHJETOR 2020		
Mbledhja		SHQYRTIMET – TEMATIKA
Nr	Datë	
1/20	05/08/2020	<p>Pas takimit të Këshillit Drejtues ku u kërkua rekomandime edhe nga komisioni për barnatore komunitare në lidhje me vendimet e fundit të Ministrit të Shëndetësisë, Komisioni ka mbajtur mbledhje urgjente në të cilat nxorri këto rekomandime :</p> <ul style="list-style-type: none">· Komisioni për barnatore komunitare ka kërkuar nga Menagjmenti dhe Kuvendi i OFK-së që në asnjë formë mos të pranohet shfuqizimi i udhëzimit administrative· Ne vlerësojmë se këto veprime janë me tendencë për berje kohe, për shfrytëzim të hapsëirës për përfitime milionëshe gjatë periudhës· Qëndrimi i tillë na obligon nga opinion i anëtarëve tanë i realizuar nga anketat e OFK-së në të cilën mbi 99% e farmacistëve janë insistues për rregullimin e menjëhershëm të cmimit të barnave· Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës të shiqojë masat vepruese gjatë të ardhmës për veprimet e radhës si formë presioni për përfundimin e përmbylljes së procesit të unifikimit të cmimit të barnave



1.6.6. Komisionit për caktimin e kushteve, kriterëve dhe përzgjedhjen e përfituesve të konkursit për përkrahjen financiare të punimeve shkencore të anëtarëve të OFK-së

Komisioni për caktimin e kushteve, kriterëve dhe përzgjedhjen e përfituesve të konkursit për përkrahjen financiare e punimeve shkencore të anëtarëve të OFK-së në periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2020, ka mbajtur 3 takim. Në takime janë shqyrtuar tematika të përshkruara si në tabelën e mëposhtme

Mbledhja		SHQYRTIMET – TEMATIKA
Nr	Datë	
1/20	23/12/2020	U vendosen prioritet e vleresimit, klasifikimi i faktoreve potencial qe ndikojnë ne vlerësim
2/20	24/12/2020	U vendos stimulimi i punes kerkimore ne nivel vendi i cili ka impakt nderkombetar dhe kredibil sipas revistave te indeksuara ne databazat elektronike, ofrimi i prioritetit punes kerkimore origjinale me metodologji te punes p.sh punes laboratorike . klinike. Prioritet origjines se punes kerkimore shkencore duke i ofruar prioritet studimeve shkencore te realizuara ne nivel vendi. Poentimi sipas kredibilitetit te revistës
3/20	30/12/2020	Shyqrtimi i apelimeve dhe përzgjedhja e përfituesve të konkursit



1.6.7. Komisioni për provim Rilicencimi

Komisioni për provimin e rilicencimit të OFK-së në periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2020, ka mbajtur 5 takime. Në takime janë shqyrtuar tematika të përshkruara si në tabelën e mëposhtme

KOMISIONI PËR PROVIM TË RILICENCIMIT		
JANAR – DHJETOR 2020		
Mbledhja		SHQYRTIMET – TEMATIKA
Nr	Datë	
1/20	13/01/2020	Hartimi i pyetjeve të provimit, përcaktimi i metodologjisë së vlerësimit dhe përcaktimi i detajeve tjera për provim
2/20	20/01/2020	Organizmi i provimit dhe vlerësimi i tij. Të paraqitur 7 anëtarë, provimit I'u nënshtruan 6 anëtarë
3/20	20/03/2020	Organizmi i provimit dhe vlerësimi i tij. Të paraqitur 2 anëtarë, provimit I'u nënshtruan 1 anëtarë
4/20	28/09/2020	Zgjedhja e kryesuesit të Komisionit me mandat 1 vjeçar znj. Rozafa Koliqi Hartimi i pyetjeve të provimit, përcaktimi i metodologjisë së vlerësimit dhe përcaktimi i detajeve tjera për provim
5/10	02/10/2020	Organizmi i provimit dhe vlerësimi i tij.



2. ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE TE EDUKIMIT TE VAZHDUESHËM PROFESIONAL NGA OFK

Oda e Farmacistëve të Kosovës me qëllim të ngritjes profesionale të anëtarëve të saj ka organizuar disa aktivitete të edukimit të vazhdueshëm profesional të akredituara me pikë kredituese për anëtarët e sajë dhe teknikët e farmacisë.

Gjatë periudhes raportuese janë organizuar këto aktivitete me pikë kredituese :

- “Menaxhimi i mbeturinave mjekësore farmaceutike në Kosovë”
- “COVID 19 dhe Farmacia në Kosovë “
- “Diabeti – Sfidat në menaxhimin bashkëkohor”

2.1 Menaxhimi i mbeturinave mjekësore farmaceutike në Kosovë”

Aktiviteti “Menaxhimi i mbeturinave mjekësore farmaceutike në Kosovë” është organizuar me Inspektoriatin Farmaceutik gjatë muajit Shkurt respektivisht me 5,6 dhe 7 Shkurt. Ky aktivitet me qëllim të afërsis dhe ekonomizimit të pjesëmarrjes nga anëtarët e OFK-së është organizuar në 3 qendrat më të mëdha rajonale në Republikën e Kosovës. Aktiviteti është akredituar me 6 pikë për pjesëmarrësit pasiv.

Aktiviteti me 5 Shkurt është organizuar në rajonin e Prishtinës, me 6 shkurt në rajonin e Prizrenit dhe me 7 shkurt në rajonin e Gjilanit.



Disa çaste nga aktiviteti i mbajtur në Prishtinë , Prizren dhe në Gjilan

2.2 “Farmacia në Kosovë dhe COVID 19”

Pas shpalljes zyrtare nga OBSH të pandemisë COVID 19, Oda Farmacistëve të Kosovës ka bërë përpjekje të vazhdueshme për qëndrim sa më afër të anëtarëve të saj përmes ofrimit të këshillave profesionale për ngritjen e vetëdijës të komunitetit farmaceutik mbi masat mbrojtëse dhe rolin e farmacistëve në përballje me situatën e krijuar. Me gjithë vështirësitë e hasura OFK ishte Oda e parë e cila filloi me mbajtjen e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm profesional në mënyrë online për anëtarët e sajë. Në këtë mënyrë me 7 Maj organizuam aktivitetin “Farmacia në Kosovë dhe COVID 19” i cili u mbajt online i cili i kushtojë situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.



Sektori i farmacisë po përballëj me sfida të shumta gjatë kësaj kohe dhe ky organizim kishte për qëllim të adresojë disa nga çështjet të cilat ishin aktuale si një përmbledhje e rekomandimeve

- të cilat kanë të bëjnë me barnatoret komunitare
- për sëmundjen në përgjithësi,
- menaxhimin e saj,
- rekomandimet për të ardhmen,
- krahasimet me shtetet tjera,
- rolin e OFK në këtë proces si dhe
- sqarimet nga vetë farmacia komunitare në Kosovë.

Në këtë trajnim, anëtarët tanë u njoftuan nga persona eminent për tema të ndryshme si :

- Pandemia COVID 19
- Evidenca nga publikimet ne farmaci ne lidhje me Covid-19
- Menaxhimi i pandemisë COVID 19 në barnatoret në Holandë
- Krizat shëndetësore; Mundësitë dhe rreziqet e industrisë farmaceutike
- Barnatoret komunitare si institucione të rëndësishme në zinxhirin shëndetësor gjatë pandemisë COVID 19
- Roli i OFK ne situatën e krijuar nga COVID 19



OFK Webinari 1 – 2020

Farmacia në Kosovë dhe COVID-19



2.3 . “Diabeti – sfidat në menaxhimin bashkëkohor”

Oda e Farmacistëve të Kosovës me qëllim të krijimi të kushteve dhe ofrimin e pikëve kredituese për rilicencim e farmacistëve përkundër rrethanave dhe vështirësive të krijuara, pas pezullimit të aktivitetit “Diabeti – sfidat në menaxhimin bashkëkohor” për shkak të masave ndaj pandemisë COVID 19 i cili ishte planifikuar të mbahej me 14 Mars, në Dhjetorin e viti 2019 ka organizuar online simpoziumin me pjesëmarrje ndërkombëtare “Diabeti – sfidat në menaxhimin bashkëkohor” . Pjesëmarrja e mbi 900 personave ishte edhe një sinjal se sa të domosdoshme dhe të nevojshme janë aktivitetet e tilla.





2.4. Konkurs për përkrahje financiare të punimeve shkencore.



Oda e Farmacistëve të Kosovës (në tekstin e mëposhtëm OFK) në mbështetje të nenit 3, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.12 të Ligjit për Odën e Profesionistëve Shëndetësorë, pikës 10 të vendimit të Kuvendit nr.83 të datës 31.12.2019 për miratimin e planit të punës për vitin 2020, pas hartimit të kriterëve dhe kushteve për përzgjedhjen e përfutësve të përkrahjes financiare për punime shkencore të anëtarëve të OFK-së nga komisioni i themeluar nga Këshilli Drejtues me vendimin nr 122 të datës 17/12/20, në vazhdim të aktivitetëve të saj, me qëllim të stimulimit si dhe promovimit të shkencës të realizuar në vendin tonë që është vlerësuar dhe botuar në revistat prestigjioze kredibile me impakt ndërkombëtar nga anëtarët e OFK-së, shpall këtë:

KONKURS PËR PËRKRAHJE FINANCIARE TË PUNIMEVE SHKENCORE

Oda e Farmacistëve të Kosovës i bënë thirrje farmacistëve anëtarë të Odës së Farmacistëve të Kosovës që të konkurrojnë për pririmin e granteve shkencore për punimet e publikuara përgjatë vitit 2020.

Pesë punimet e përzgjedhura sipas kriterëve të poshtëshënuara do të përfitojnë shumën në vlerë prej:

- Vendi i parë € 600
- Vendi i dytë € 500
- Vendi i tretë € 300
- Vendi i katërt € 200
- Vendi i pestë € 200

KRITERET DHE PROCEDURAT E APLIKIMIT:

Kriteret obligative të pranimit janë:

- Farmacisti duhet të jetë anëtar i Odës së Farmacistëve të Kosovës
- Farmacisti duhet të jetë autor i parë i punimit shkencor;
- Periudha kohore e publikimit të punimit në revistë shkencore duhet të jetë përgjatë vitit 2020

Kriteret selektive të pranimit illogariten me pikët si vijon:

1. Origjina e punimit

- a) Institucioni primar dhe gjenerimi i punimit në nivel vendit (Kosovë), së bashku me autorin korrespondues Kosovar vlerësohet me (7 pikë) duke u bazuar në paragrafin e parë të stimulimit dhe promovimit të shkencës në institucionet relevante kërkimore në Kosovë
- b) Institucioni primar dhe gjenerimi i punimit në nivel vendit (Kosovë), por me autor korrespondues jashtë vendit vlerësohet me (5 pikë)
- c) Institucioni primar dhe gjenerimi i punimit jashtë vendit (Kosovës) vlerësohet me (2 pikë)

Oda e Farmacistëve të Kosovës në vazhdim të aktivitetëve të saj, duke u bazuar në dispozitat e Rregullores për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional në lidhje me përkrahjen, zhvillimin e kapaciteteve shkencore vendore me qëllim të stimulimit si dhe promovimit të shkencës të realizuar në vendin tonë që është vlerësuar dhe botuar në revistat prestigjioze kredibile me impakt ndërkombëtar, me vendim të këshillit drejtues dhe vendim të komisionit për përzgjedhje të punimeve shpall, konkurs për përkrahje financiare të punimeve shkencore.

2. OFK dhe COVID 19

Oda e Farmacistëve të Kosovës me qëllim të lehtësimit dhe mbrojtjes së anëtarëve të saj gjatë shërbimit të farmacistëve si vije e parë e përbaljes me COVID 19 në vazhdimësi ka njoftuar anëtarët e sajë mbi hulumtimet dhe masat mbrojtëse nga ana e instucioneve dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare .

- 11 Mars 2020, OFK ka njoftuar anëtarët e saj me rekomandimet e FIP (Federata Ndërkombëtare e Farmacisë) për punën e farmacistëve gjatë pandemisë të cilat janë marrë nga Shoqata e farmacistëve të Kinës ku edhe ka filluar shpërthimi i Coronavirusit.
- 11 Mars 2020, OFK ka njoftuar anëtarët e saj me rekomandimet e Aleancës Botërore e Profesionistëve Shëndetësorë (Përfshirë FIP)
- 12 Mars 2020, OFK ka njoftuar anëtarët e sajë më udhërrëfyesin për koronavirus përmes publikimeve të FIP të përkthyer nga ana e OFK-së përmes së cilave janë ofruar këshilla



mbi punën e farmacistëve dhe masat mbrojtëse brenda barnatoreve gjatë ofrimit të shërbimit shëndetësor

- 13 Mars 2020, OFK ka njoftuar anëtarët e saj me rekomandimet e FIP (Federata Ndërkombëtare e Farmacisë) dhe OBSH (Organizata Botërore e Shëndetësisë) lidhur me formulimet e ndryshme të cilat mund të përgatiten lehtë në laboratorët e barnatoreve në mungesë të përgatesave të gatshme në formë xhelesh apo tjera
- 15 Mars 2020, OFK njofton anëtarët e sajë, për rekomandimet konkrete për mënyrën e ofrim të shërbimit shëndetësor dhe masat mbrojtëse të personelit shëndetësor në barnatore, të hartuara së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Agjensinë e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale
- 16 Mars 2020, Përfaqësues të Odave të Profesionistëve Shëndetësore dhe Institucioneve Shëndetësore mbajtën takim me Ministrin e Shëndetësisë z.Arben Vitia dhe Sekretarin e Përgjithshëm të MSh z.Naim Bardiqi dhe zv/ministrin i Ministrisë së Punëve të Brendshme, z. Xhelal Sveçla. Në këtë takim u ritheksua roli i rëndësishëm që kanë profesionistët shëndetësorë në menaxhimin e kësaj situatë. Gjithashtu u bisedua lidhur me çështjen e furnizimeve dhe lëvizjeve në vendet e karantinuara duke u dhënë disa rekomandime nga ana e profesionistëve shëndetësorë, të cilat më pas do të diskutohen në kuadër të komitetit për të marrë formën përfundimtare të vendimit.
Këto dhe masat e tjera të dakorduara njëzëri në këtë takim i cili do të koordinohet si një trup i vetëm në mbrojtje të shëndetit të popullatës, do të publikohen pasi që ato të aprovohen nga Komiteti për Menaxhimin e Emergjencave, pjesë e të cilit janë të gjitha institucionet relevante.
- 18 Mars 2020, OFK njofton anëtarët e sajë mbi njoftimin e Agjencis Europiane e Barnave pas shqetësimit lidhur me përdorimin e ibuprofenit në rastet me COVID 19
- 19 Mars 2020, OFK ka filluar shpërndarjen e postereve në barnatore mbi masat mbrojtëse nga COVID 19
- 23 Mars 2020, OFK njofton anëtarët e sajë me mesazhet senzibilzuese të farmacistëve nga mbarë bota si Ariana Cakiqi – Holand, Arton Baftiu – Norvegji, Mjellma Hatipi – Kanada
- 25 Mars 2020, OFK njofton anëtarët e sajë mbi ngatërresat e shpeshta dhe dallimet në mes virusit dhe sëmundjes



- 25 Mars 2020, OFK njofton anëtarët e sajë mbi përdorimine barnave për trajtimin e COVID 19 dhe aprovimin nga institucionet përgjegjëse ndërkombëtare
- 26 Mars 2020, OFK ka njoftuar anëtarët e sajë mbi vendimet e qeverisë rreth kufizimit të lëvizjes së lirë dhe orareve të ushtrimit të veprimtarisë së barnatoreve
- 28 Mars 2020, OFK njofton anëtarët e sajë mbi shkurtimin e orarit të punës së barnatores dhe organizimin e kujdestarive
- 3 Prill 2020, me qëllim të verifikimit të përvojave të farmacistëve komunitare me COVID 19 ka publikuar pyetësin I cili ishte pjesë e një studimi që kishte për qëllim të hulumtojë përvojat e farmacistëve gjatë kësaj situate të paprecedent për profesionin e farmacistit dhe shëndetit publik në përgjithësi.
- 7 Prill 2020, OFK njofton anëtarët e sajë mbi njoftimin e Ministrisë së Financave dhe Transfereve mbi publikimin e planit operacional për realizimin e pagesës shtesë në vlerë prej 100 € për farmacistët nga Qeveria e Kosovës.
- 8 Prill 2020, OFK dënon ashpër ushtrimin e veprimtarisë nga barnatore të palicencuara dhe punën nga personat jokompetent në ofrimin të shërbimeve për COVID 19
- 12 Prill 2020, nga kjo datë OFK filloi publikimin e barnatoreve kujdestare me link mbi adresën e vendodhjes së barnatoreve me qëllim që qasja e qytetarëve në shërbim shëndetësorë të jetë sa më e lehtë dhe efikas
- 14 Prill 2020, OFK njofton anëtarët e sajë mbi organizimin e ri të orarit të punës së barnatoreve
- 14 Prill 2020, OFK njofton anëtarët e sajë mbi formën e re të vërtetimit mbi lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe profesionistëve shëndetësor
- 21 Prill 2020, OFK njofton anëtarët e sajë mbi organizimin e ëëbinareve nëpër botë të cilat për temë kanë Rolin e Farmacistit në Pandeminë COVID 19,
- 29 Prill 2020, Odat e Profesionistëve Shëndetësor (Oda e Mjekëve të Kosovës, Oda e Stomatologëve të Kosovës, Oda e Farmacistëve të Kosovës dhe Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës) dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSShK) zhvilluan takimit të përbashkët konsultativ mbi gjendjen e profesionistëve shëndetësor gjatë pandemisë COVID 19. Në këtë takim janë paraqitur sfidat që burojnë nga secili sektor dhe profil profesional, duke vlerësuar edhe aspektin e sigurisë dhe shëndetit në punë në rrethanat aktuale në të cilat profesionistët shëndetësor janë duke ofruar shërbimet



shëndetësore. Po ashtu, në këtë takim është diskutuar edhe nevoja dhe rëndësia e stimulimit të profesionistëve shëndetësor, si dhe zbatimin korekt të pakos emergjente për pagesat shtesë për punën gjatë pandemisë, në të dy sektoret, ate publik dhe privat

- 20 Maj 2020, Kërkesa e OFK-se per Ministrine e Financave dhe Transfereve per plotesim ndryshimin e Pakos Fiskal Emergjente me masa ne ndihme te sektorit farmaceutik ku ndër të tjera u propozua “që brenda masave të ndërrmara të përfshihet edhe Barnatoret, pasi stafi shëndetësorë brenda tyre është ndër më të rrezikuarit për infektim pasi gjdo ditë ballafaqohet me të prekur të mundshëm nga kjo pandemi. ***Me këtë rast, shprehim paknaqësinë e anëtarëve tonë duke e konsideruar si diskriminues veqimin e farmacistëve nga profilet e tjera shëndetësore duke i kategorizuar në pozitë të barabartë me disa subjekte tregtare, përkundër se sipas legjislacionit në fuqi Barnatoret janë institucione shëndetësore që funksionojnë në të tri (3) nivelet e kujdesit shëndetësor (neni 17, paragrafi 5 i Ligji për Shëndetësi nr. 04/L-125) dhe farmacistët konsiderohen si profile të profesionistëve shëndetësorë (neni 69, paragrafi 1.2 i Ligji për Shëndetësi nr. 04/L-125).*** Oda e Farmacistëve kërkon që në asnjë rast reagimi i sajë të mos keqkuptohet si reagim ndaj subjekteve tregtare, por si reagim përmes të cilët kërkohet trajtim meritor, dinjëtoz dhe ligjore i barnatoreve dhe farmacistëve. Shfrytëzojmë rastin të shprehim mirënjohje për të gjitha subjekteve tregtare për punën e tyre duke u solidarizuar me përkrahjen e Qeverisë për këto subjekte dhe duke i konsideruar si subjekte me rëndësi të veçantë duke i pasur parasysh shërbimet e tyre për qytetarëve e Kosovës, në këtë kohë pandemi Siq edhe u tha më lartë, pas vendimit nr.02/2017 të Qeverisë së Kosovës, një numër i farmacistëve kanë humbur vendet e tyre të punës, andaj me qëllim të lehtësimit të kushteve të tyre në këtë kohë, propozojmë Qeverisë së Kosovës :
- a. Të sigurohen pagat për të gjitha farmacistët, të cilët kanë shkëput mardhëniet e punës pas shpalljes së gjendje së emergjente si pasojë e gjendjes financiare të barnatoreve
 - b. Pagat e punëtorëve të paguhen në bazë të listës së pagave të të punësuarve të realizuara nga muaji paraprak pëmes ATK-Trusti.



c. Autoritet kompetente (p.sh inspektoriat i punës) të monitorojë ligjshmërinë dhe procedurën e shëkputjes së këtyre kontratave”

- 31 Maj 2020, njoftimi i anëtarëve për shfuqizimin e vendimeve mbi majtjen e kujdestarive nga Barnatoret
- 25 Qershorë 2020, OFK njofton anëtarët e sajë mbi aprovimin e parë për trajtimin e COVID 19
- 21 Korrik 2020, OFK kërkon nga komunat ë gjithë komunat në të cilat vlen vendimi për kufizim kohor se barnatoret nuk mund të trajtohen si subjekte afariste biznesore gjatë inspektimeve. OFK ka sqaruar se sipas legjislacionit aktual nenit 17, paragrafi 5 të Ligjit të Shëndetësisë nr.04/L-125, Barnatoret janë institucione shëndetësore përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Prandaj edhe trajtimi i veprimtarisë së barnatoreve duhet të parë në kuadër të këtyre dispozitave ligjore. Vendimi mbi kufizimin e lëvizjes së lirë të qytetarëve në pikën 5 parasheh përjashtimet nga orari i kufizuar për rastet me nevojë urgjente shëndetësore. Prandaj, barnatoret kanë për detyrim ligjor ofrimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarë dhe për këtë nuk mund ti ndalohej ushtrimi i veprimtarisë shëndetësore pas orës 21:00 pasi veprimtaria e tyre nuk është e ndaluar, përveç rastet kur komunat i kanë të rregulluara kujdestarit.

3.1. Donacioni OFK-së për anëtarët e sajë – maska mbrojtëse

Oda e Farmacistëve të Kosovës ka pranuar një donacion prej më shumë se 1000 mburoja fytyre (Face Shield) nga BONEVET të cilat u dorëzuan në disa faza. Këto mburoja janë shpërndarë nëpër barnatoret nga dy maska për barnatore





3. 25 Shtatori (Dita Botërore e Farmacistit)

Oda e Farmacistëve të Kosovës në nder të 25 Shtatorit, Ditës Botërore të Farmacistit ka mbajtur konferencë për shtyp me të cilin janë adresuar shqetësimet kryesore të sektorit tonë veçmas problematiken e unifikimit të çmimeve të barnave në Kosovë.

Këtë ditë farmacistët në Kosovë më shumë e shënouan si një protestë me kërkesa të cilat janë për rregullimin e profesionit që fillon nga nivelizimi i çmimeve të barnave, zbatimin e recetës për barna, rregullimin e numrit të barnatoreve sipas kriterëve gjeografike, demografike dhe zbatimin e plotë të praktikave të mira të farmacisë, kufizimin e pronësisë së barnatoreve vetëm në ata që kanë licencë për ushtrimin e një veprimtarie të tillë (si në shumicën e shteteve në bashkimin europian), funksionalizimin e farmacisë spitalore, rregullimin e procesit të specializimeve për farmacistët e shumë kërkesa tjera që do të sillnin ngritjen e profesionalizmit dhe ofrimin e shërbimeve cilësore në sektorin farmaceutik qoftë në komunitet apo edhe në spital.






4. Të tjera

4.1. Anketa per unifikimin e çmimit te barnave

Në qershorë 2020, OFK në mënyrë elektronike ka lansuar anketën me anëtarët e sajë për çështjet nga unifikimi i çmimit të barnave.


Në anket janë përgjigjur 644 farmacistë prej të cilëve 99.4% janë shprehur se Kosova domosdoshmërisht duhet të ketë çmime të rregulluara, 95.3% që kjo të vlejë për të gjitha abrnat dhe 90.8% që kjo të bëhet sa më parë (shih grafikonet e mëposhtme):





A mendoni se çmimet e barnave duhet të jenë të rregulluara vetëm për:


644 responses



- Listën esenciale (për institucionet publike shëndetësore)
- Barnat e listës së reimbursimit (për sigurime shëndetësore)
- Të gjitha barnat
- Barnat e listës së reimbursimit (për sigurime shëndetësore)

A mendoni se çmimet e barnave duhet të bëhen sa më parë apo të priten sigurimet shëndetësore:

644 responses



- Duhet të bëhen sa më parë
- Duhet pritur sigurimet shëndetësore

4.2. Tryeza “Ligji për paga dhe Papunësia në rradhët e profesionistëve shëndetësorë”

Qëllimi i organizimit të tryezës ishte të mbledhë akterët kyç të sektorit shëndetësor për të diskutuar rreth shqetësimit për numrin e madh të profesionistëve shëndetësorë të papunë, ikja e tyre nga Kosova dhe nevojat e sistemit shëndetësor për profesionistë shëndetësorë sipas specializimeve por edhe çështja që ndërlidhet me Ligjin për paga në institucionet publike.

Me këtë rast nga kryetari i OFK për problemet që ndërlidhen me këtë temë theksoi ndër të tjera se është e domosdoshme të bëhet:

- Riorganizimi i profesionistëve shëndetësorë në të tri nivelet e sektorit shëndetësor e sidomos ata në nivel terciar nëpër klinika dhe dhënia e përgjegjësisë sipas llojit të specializimit.
- Gjithashtu theksimi i çështjes që të mos bëhet diskriminim në pagë për kolegët të cilët janë të punësuar në institucionet si MSH (përfshirë Inspektoratin), AKPPM, FSSH, etj.



U theksua që sa më parë të hapen konkurset për specializime ku edhe për profilet e farmacistëve edhe kjo është domosdoshmëri që të kihet parasysh roli dhe rëndësia e tyre për sistemin shëndetësor.



4.3. Takimi i përbashkët i OPSH me Ministrin e Shëndetësisë

Qershorë 2020 - Kryetari i OFK Arianit Jakupi së bashku me kryetarët e Odës së Mjekëve Z.Pleurat Sejdiu dhe Odës së Stomatologëve Z.Blerim Kamberi takojnë Ministrin Zemaj Oda e Farmacistëve, Oda e Mjekëve dhe Oda e Stomatologëve ishin në takim me Ministrin e Shëndetësisë z. Armend Zemaj, me ç ‘rast u diskutua për gjendjen aktuale të pandemisë Covid 19 dhe punëtorët shëndetësor.

Konkretisht në këtë takim u bisedua rreth vazhimit të bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Odave të Profesionistëve Shëndetësor në luftimin dhe parandalimin e pandemisë Covid 19.

Kryetari i Odës së Farmacistëve njoftoi Ministrin për punën profesionale e cila zhvillohet në OFK në të gjitha komisionet e OFK por posaçërisht proceset e punës të cilat edhe gjatë kohës së pandemisë janë zhvilluar në funksion të një stabiliteti të sektorit farmaceutik gjatë këtyre muajve.



Temë e takimit ishte procesi i specializimeve për farmacistët, rregullimi i disa neneve në udhëzimin administrative dhe harmonizimi me Ligjin e OPSH dhe Ligjin për Shëndetësi, por edhe çështja e farmacistëve që aktualisht janë specialistë dhe që duhet patjetër të finalizohet statusi i tyre Brenda institucioneve shëndetësore.

Gjithashtu u diskutua në mënyrë të veçantë për udhëzimin për çmime që aktualisht janë paraqitur disa paqartësi dhe është bërë një pezullim i përkohshëm i punës deri në sqarimin nga departamenti ligjor. Nga Ministri u kërkua që të ketë një vëmendje të posaçme në këtë udhëzim administrativ pasi që është një nga proceset më të rëndësishme dhe me ndikim për tërë sektorin.


4.4. Kërkesa në MSH për hapjen e vendeve për specializim për profilet e farmacistëve

Me 24 Korrik 2020, Kryetari OFK-së përmes shkresës me nr protokolli 05-4674 ka kërkuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë përfshirjen e profileve farmaceutike në konkursin për specializim . Përmbajtja “OFK e konsideron si shumë të nevojshme dhe jetike që në këtë periudhë të përbaljes me pandeminë COVID 19 të ketë prezencë të farmacistëve me theks të veçantë të profilit farmaci klinike dhe hulumtim i barnave të cilët edhe ashtu janë të pakët në instucione shëndetësore dhe nuk mjaftojnë as për funksionim të shërbimeve esenciale në kuadër të këtyre instucioneve. Për më tepër prezenca e

farmacistëve është detyrim ligjor i përcaktuar nga **neni 26 paragrafi 2 i Ligjit për Shëndetësi nr. 04/L-125 “Barnat e përshkruara nga mjeku ose stomatologu mund të jepen vetëm nga ose në prezencën e farmacistit të licencuar “**

Për më tepër edhe hulumtimet ndërkombëtarë faktojnë nevojën e prezencës së farmacistëve gjatë përshkrimit të barnave të cilat tregojë se përqindja e gabimeve në përshkrim të terapisë është shumë me vogël në rastet kur kjo bëhet në prezencën e farmacistit (22 në 10000 dispENZIME) për dallim nga rastet kur dispENZIMI është bërë nga infiermierët ku përqindja e gabimeve varion nga 15% deri në 45 %.

Të nderuar duke parë nevojën për këto profile farmaceutike, kërkojmë mirëkuptimin tuaj për plotësimin e këtij konkursi për






shkollim specialistik duke përfshirë edhe një numër të profileve farmaceutike”

4.5 Konferenca mbi shfuqizimin e UA për unifikimin e çmimit të barnave

Me datën 5 Gusht 2020, Oda e Farmacistëve të Kosovës me vendim të Këshillit Drejtues ka organizuar konferencën për media në lidhje me vendimin e ministrit të shëndetësisë për shfuqizimin e UA për unifikimin e çmimit të barnave.

Në këtë konferencë, u pasqyrua efekti i këtij vendimi në sektorin farmaceutik, dhe aspekti juridik i



kundërshtimit në zyrën e kryeministrit të këtij vendimi .

Pas mbajtjes së konferencës përfaqësuesit e OFK-së u ftuan për takim të përbashkët me palët e interesit në sektorin farmaceutik dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Në këtë takim OFK, shprehu qendrimin e sajë se ky vendim i ministritë duhet të anulohet dhe të krijohet komisioni i ri i ankesave për përmylljene e procesit. Në këtë takim, Ministri i

Shëndetësisë paraqiti propozimin e tijë për pezullimin e vendimit të tijë dhe fillimin e procesit të plotësim ndryshimit të udhëzimit administrative për cmime.


OFK edhe njëherë qartësoi qëndrim e sajë në takim për anulim të vendimit dhe vazhdim të mëturjeshëm të procesit, dhe njoftoi Ministrinë për takimin e Kuvendit të OFK-së në të cilin do të vendoset për masat të cilat do të ndërmerren nga komuniteti jonë duke mos përjashtur edhe protestat dhe grevat si masë e fundit.

4.5. OFK pjesë e iniciativës për qirinjë në nderë të profesionistëve shëndetësor të cilët humbën jetën nga COVID 19

Me datën 20 Gusht 2020, Oda e Farmacistëve të Kosovës, u bashkua në iniciativën e OPSH-ve për thirrje institucioneve shëndetësore që me datë 20 gusht 2020, në orën 21.00 para çdo institucioni shëndetësor të ndizen qirinjë në nder të profesionistëve shëndetësor të cilët humbën jetën nga Covid



19, si dhe të shërbej si mbështetje të profesionistëve shëndetësor të cilët vazhdojnë luftën kundër Covid 19.



4.6. Lobimi Dogana e Kosovës

Me 30.09.2020, Ministrija e Financave Znj.Hykmete Bajrami ka pritur në takim të përbashkët përfaqësuesin e OFK-së, Kryetarin e SHDFMK-së dhe përfaqësuesin e Doganave të Kosovës për të diskutuar mbi problematiken e depove doganore për subjektet farmaceutike.

Gjatë takimit është prezantuar qëndrimi i përbashkët i OFK – SHDFMK mbi nevojën dhe domosdoshmërinë e ekzistimit të depove doganore farmaceutike, me ç'rast u premtua nga përfaqësuesit e Doganës së Kosovës se së shpejti kjo çështje do të zgjidhet.

Pas trajtimit të kësaj problematike, Dogana e Kosovës ka njoftuar se të gjitha subjekteve që merren me importin dhe tregtimin e produkteve farmaceutike nuk kanë pengesë ligjore për të aplikuar për licencimin e depove doganore.



4.7. Reagimi publik ndaj kronikave mediale për kontrabandën e barnave

Oda e Farmacistëve të Kosovës me datën 15 Nëntor 2020 ka paraqitur deklaratën publike në lidhje me kronikat mediale të cilat kanë stigmatizuar farmacistët si kontrabandues të barnave.

Përmbajtja e deklaratës “*Me shkas lidhur me disa kronika për kontrabandën me barna!*”

Këtyre ditëve në disa media por edhe nga raporti i kryeinspektorit u dhanë shifra shumë shqetësuese rreth punës në barnatore, çmimeve të barnave dhe kontrabandës dhe kjo tregon se diçka (lexo shumëçka) nuk është në rregull.

Ne si OFK i pyesim politikëbërësit: Pse po ndodhin këto fenomene? Pse ka kontrabandë të barnave? Pse ka ndryshime të çmimeve? Pse janë çmimet kaq të shtrenjta? Pse shumëçka???

Në rast se ka kontrabandë, apo nëse ka parregullësi në një barnatore (apo në një numër të izoluar të rasteve) mund të jetë rezultat i cili mund të ketë trajtim të shpejtë por në rast se ky është fenomen i zgjeruar në masë atëherë ky problem duhet ti zgjojë politikëbërësit.

Farmacistët janë viktima të këtij sistemi (përfshijto disa raste individuale) dhe ata të cilët ka shumë vite po kërkojnë rregullimin e sistemit të farmacisë me disa prej çështjeve, si:

- Çmimet e barnave (udhëzimi në fuqi por nuk po zbatohet)
- Kufizimi i numrit të barnatoreve në raport me numrin e banorëve
- Përcaktimi i distancës mes barnatoreve
- Kufizimi i pronësisë - pronari farmacist
- Zbatimi i orarit të plotë të punës me prezencë të farmacistit/farmacistëve
- Zbatimi i recetës për barna
- Reimbursimi i barnave
- Etj, etj.

Shembujt me ndryshimet marramendëse të çmimeve dhe pasojave të kontrabandes në mënyrë të vazhdueshme janë theksuar në raportet dhe kërkesat e shumta nga OFK si fenomene të papranueshme dhe me pasoja shumë të rënda për sektorin farmaceutik dhe për punën në barnatore.

Prandaj në këto raporte të mediave të cilat janë mëse të mirëpritura ne si OFK do të kërkonim një ndryshim të bëhej që viktima të mos paraqitet si shkelës, e i përgjithësuar si profesion i tërë. Importi i barnave në shumicën absolute të rasteve nuk bëhet nga farmacistët dhe kontrabanduesit gjithashtu nuk janë farmacistët. Farmacistët janë shkalla e fundit e këtij zinxhiri - në barnatore dhe deri sa procesi vjen në fund janë disa shkallë, prandaj mos ia mvishni kontrabanden farmacistit.



Importuesit, kontrabanduesit, individët e caktuar duhet të ndiqen në mënyrë individuale, kurse politikëbërësit duhet të hartojnë politika, ligje të zbatueshme dhe të cilat do të mundësojnë përmbushjen e nevojave të qytetarëve me barna të cilat janë të sigurta cilësore, efektive dhe me kosto të përballueshme (dhe të ngjashme me tërë rajonin).

Në fund përsëri një pyetje që duhet të analizohet: PSE KA KONTRABANDË TË BARNAVE? Vetëm kur politikëbërësit të analizojnë dhe kuptojnë me kujdes shkaqet pse po ndodhin këto fenomene atëherë do të jetë fillimi i zgjidhjes së tyre.”

4.8. Propozimet e OFK-së për plotësim ndryshimin e UA-11/15 për qarkulluesit me pakicë të produkteve farmaceutike

Me 21 Tetor 2020, OFK ka dorëzuar në Ministrinë e Shëndetësisë përmes shkresës nr proktokolli 05-6691 propozimet e sajë mbi nevojën e plotësim ndryshimt të UA nr. 11/15

Propozimet e OFK-së

Propozimi I-rë (propozim i ri – jo i përfshirë në grupin punues)

Nënparagrafi 1.2 i paragrafit 1 të Nenit 3 të riformulohet si në vijim :

“Bartësi i licencës profesionale për barnatore – farmacisti i licencuar i cili paisjet me licencë profesionale për barnatore, për qarkulluesit me pakicë të produkteve dhe paisjeve medicinale “

Arsyetim

Ligji për leje dhe licenca në nenin 3, paragrafi , nënparagrafi 1.10 përcakton se **“Licencë profesionale – lloj lejimi i dhënë njëpersoni fizik për tu angazhuar në një profesion me tu përcaktuar nga autoriteti kompetent se ky profesion paraqet rrezik të mesëm apo të lartë për shëndetin publik, sigurinë dhe mjedisin siç përcaktohet me ligj.”**

Për më tepër neni 14, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.2 dhe paragrafin 3 i Ligjit për Produkte dhe Paisje medicinale si ligj organit me të cilin rregullohet veprimtaria e qarkulluesve me pakice të paisjeve



dhe produkteve medicinale, njeh diskrecionin e aktit nënligjorë për caktimin e kushteve për ushtrimin e veprimtarisë së barnatoreve dhe kjo në asnjë mënyrë nuk nënkupton ndërhyrje në licenca të biznesit.

Formulimi i tillë do të ishte në përputhje të plotë me nenin 3, paragrafin 1.10 të Ligjit për leje dhe licenca i cili thekson se licencë profesionale i lëshohet personit fizik.

Ne këtë propozim e bazojmë edhe mbi licencat tjera profesionale që lëshohen nga Ministrinë tjera. P.sh Ministria e Drejtësisë licencon noterët dhe të drejtën për ushtrimin e veprimtarisë njeh vetm personit fizik i cili ka të përfunduar provimin për noteri. Me rastin e licencimit caktohet personi fizik si bartës i asaj licence dhe caktohet adresa ku është selia e ushtrimit të veprimtarisë Për më tepër shih konkursin e Ministrisë së Drejtësisë të datës 23/07/2019 në të cilin kusht për ushtrim të profesionit të noterisë (zyrës noteriale) ka Certifikatën për dhënien e provimit të Noterisë, të lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, dhe licencat e lëshuara nga Ministria e Drejtësisë të publikuar në ëeb faqen e tyre. Po ashtu rastet e avokateve,.

Ne dëshirojmë të sqarojmë se qështja e regjistrimit në Agjensionin e Bizneseve (Licenca e Bizneseve) është krejtësisht qështje tjetër ashtu sic është paraparë edhe në dispozitën e nenit 14, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.1. dhe për më tepër është i rregulluar edhe me ligjin për shoqëritë tregtare dhe si e tillë qështja e regjistrimit të biznesit nuk është në fushëveprimin e AKPM-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Këtë po e theksojmë meqë në grupin punues nuk arrihej të bëhej dallimi midis licencës profesionale dhe asaj të biznesit.

Cështja e pronësisë tashmë është e rregulluar në shumicën e shteteve të Evropës

Kjo cështje tashmë është sfiduar edhe në kuadër të

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropianë tashmë ka nxjerr vendime me të cilin është përcaktuar e drejta e pronësisë së farmacisë (barnatores) si e kufizuar vetëm për farmacistët.

Me vendimin e sajë të datës 19 Maj 2009 në rastin e njohur si “ *Case C-531/06 and in Joined Cases C-171/07 and C-172/07, Commission v Italy & Apothekerkammer des Saarlandes and Others* “ qështjen e pronësisë vetëm nga farmacisti e arsyeton se “ *farmacisti me profesion, supozohet se operon me barnatoren jo me një objektiv thjesht ekonomik, por edhe nga pikëpamja profesionale. Interesi i tij privat i lidhur me krijimin e një fitimi zbutet nga edukimi i tij, nga përvoja e tij profesionale dhe nga përgjegjësia që i detyrohet, duke pasur parasysh që çdo shkelje e rregullave të ligjit ose sjellje profesionale minon jo vetëm vlerën e investimit të tij, por edhe ekzistencën e tij*



profesionale. Ndryshe nga farmacistët, jo-farmacistët nga përkufizimi nuk kanë trajnim, përvojë dhe përgjegjësi ekuivalente me ato të farmacistëve. Prandaj, ato nuk ofrojnë të njëjtat masa mbrojtëse si farmacistët. Prandaj, një shtet anëtar mund të marrë mendimin, në ushtrimin e gjyqimit të tij, që funksionimi i një farmacie nga një jo-farmacist mund të paraqesë një rrezik për shëndetin publik, veçanërisht për besueshmërinë dhe cilësinë e furnizimit të produkteve medicinale me pakicë “

Për më tepër gjykata në këtë rast ka konstatuar se “Kur ekziston pasiguri për ekzistencën ose shkallën e rreziqeve për shëndetin e njeriut, është e rëndësishme që një Shtet duhet të jetë në gjendje të marrë masa mbrojtëse pa pasur nevojë të presë derisa realiteti i atyre rreziqeve të bëhet plotësisht i dukshëm.”

Po ashtu gjykata tërheq vëmendjen për natyrën shumë të veçantë të produkteve medicinale, efektet terapeutike të cilave dallojnë ato në mënyrë të konsiderueshme nga mallrat e tjera, për të cilat është konstatuar se barnatorja duhet të ketë pronar farmacist.

Sipas gjykatës pronari jo-farmacist ka për qëllim parësor fitimin mbi shëndetin e individit dhe të popullatës

Prandaj mbi këto baza gjykata ka konstatuar se përcaktimi i Gjermanisë dhe Italisë të cilat lejojnë në legjislacionin e tyre hapjen e barnatoreve vetëm nga farmacistët me profesion për shkak të specifikave të produkteve medicinale nuk paraqet shkelje të të drejtave të njeriut.

Për më tepër shih vendimin e gjykatës të bashkangjitur si shtojca I në këtë shkresë

Po ashtu edhe praktika e shteteve evropiane tregon se në legjislacionin e tyre, kjo e drejtë e pronësisë së një farmacie në komunitet është e kufizuar në një farmacist (ose një grup farmacistësh)

Arsyeja kryesore është se konsiderohet se mundësohet një nivel i lartë gjykimi profesional duke zbutur rreziqet e pronësisë së korporatave, të cilat mund të japin direktivat për të favorizuar fitimin mbi shëndetin e individit dhe të popullatës.

Shtetet e ndryshme njohin të drejtën që një licencë e barnatores të jetë e transferueshme të një farmacist apo grup i farmacistëve me kusht që te personat që transferohet licenca ti kenë plotësuar kushtet për licencim pra edhe ata të jenë farmacist. Raste të tilla përshembull Gjermani dhe Spanja ku pronari i një barnatore duhet të jetë gjithmonë farmacist.

Rregull të tillë të transferit përmban edhe paragrafi 3 i Nenit 25 të Ligjit për leje dhe Licenca nr. 04/L-202.



Poloni qështjen e të drejtës së vetme të farmacistit për hapjen e barnatoreve e ka të rregulluar që nga viti 2017. Disa shtet të tjera si Austria, Hungaria dhe Letonia parashohin kufizimin që shumica e aksioneve të barnatoreve të jenë në pronësi të farmacistit.

Për të parë më shumë praktikën e vendeve evropiane të Rregullimit të qështjes së pronësisë së barnatores ju lutem referohuni në shtojcën II të bashkangjitur kësaj shkrese, i cili është një dokument nga Organizata Botërore e Shëndetësisë e cila përman kornizën rregullative dhe ligjore të rregullimit të qështjes së pronësisë . Për më tepër kjo rregullativ mund të gjendet edhe në linkun e bashkangjitur <https://apps.ëho.int/iris/bitstream/handle/10665/326394/9789289054249-eng.pdf?sequence=1&isAlloëed=y>

Prandaj, duke mos parë pengesë në legjislacionin aktual, vendimet e Gjykatës të Drejtësisë të Bashkimit Evropaine, këtë formulim e konsiderojmë si më adekuatin dhe në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.

Propozimi 2 (mos pajtim me propozimin e grupit punues)

Ne propozojmë lartësia e përcaktuar në nënparagrafin 1, paragrafi 2 të nenit nenin 4, të mbetet ashtu siq është aktualisht 2.6 m

Arsyetim

OFK konsideron se cfardo shmangje nga lartësia e tillë do të shkaktonte kaos në barnatore gjatë rilicencimeve dhe do të ishte shmangje e praktikës së deritanishme si dhe standardeve ndërkombëtare

Propozimi 3 (mos pajtim me propozimin e grupit punues)

Nënparagrafi 2.2, i paragrafit 2 të nenit 4, të mbetet ashtu siq ka qenë ose të saktësohet lartësia 2.6m

Arsyetim

Të zbatohet standardi i njejtë si në nënparagrafin 1, paragrafi 2 të nenit nenin 4 të udhëzimit bazë.

Propozimi 4, (mos pajtim me propozimin e grupit punues)



Nënparagrafi 2.3 i paragrafi 2 të nenit 4 të mbetet si është aktualisht në udhëzimin bazë.

Arsyetim

Barnatoret aktuale përmbushin kriteret e përcaktuar, prandaj çfardo lëvizje nga këto kritere në aspektin infrastrukturor do të shkaktonte kaos në to dhe do të ishte i harmonizuar me nënparagrafin 1.

Propozimi 5 (plotësim dhe arsyetim i propozimit të grupit punues)

Pas paragrafit 5 të nenit 4 të udhëzimit administrativ bazë shtohet një paragraf i ri me numër rendor 6 dhe një nënparagrafi i ri si 6.1 si në vijim:

6. Qarkulluesi farmaceutikë me pakicë për produkte dhe pajisje medicinale duhet të këtë distancë minimale prej 300 m diametër nga subjekti tjetër i të njëjtës veprimtari.

6.1 Kriteri mbi distancën prej 300 m nuk zbatohet në rilicencim ndaj barnatoreve të cilat të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë e kanë fituar para hyrjes në fuqi të kësaj dispozite “

Arsyetim

OFK e konsideron si të nevojshme kriterin e distancës në mes barnatoreve të reja e cila si kriter duhet të vlejë vetëm ndaj barnatoreve të cilat licencohen për herë të parë dhe nuk duhet të vlejë në procesin e rilicencimit. Një kriter të tillë do të ndikonte edhe në shpërndarjen proporcionale të barnatoreve nëpër lokalitete të ndryshme . Sa i përket kriterit 300 metra, është marrë një mesatare e bazuar edhe në shtojcën II të bashkangjitur të dokumentit të OBSH-së në faqen 21 në të cilën janë përshkruar distanca në disa shtet si Austria 500m, Kroacia 200 deri në 500 m, Italia 200 m , Polonia 500m, Sllovenia 400 etj

Për më shumë shih shtojcën II në faqën 21 ose në linkun <https://apps.ëho.int/iris/bitstream/handle/10665/326394/9789289054249-eng.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

Propozimi 6. (propozim i ri nga grupi punues)



Paragrafi 4 i Nenit 6 të riformulohet si në vijim *“Në rastet kur farmacisti nuk mund të jetë prezent në barnatore, bartësi i licencës profesionale të barnatores është i obliguar që ta angazhojë farmacistin zëvendësues me licencë valide, i cili autorizohet për kryerjen e detyrave të farmacistit “*

Arsyetim

Përmbajtja aktuale e udhëzimit bazë 11/15 lejon mundësi kolizioni të interpretimit pasi e njëjta qështje rregullohet në mënyrë të ndryshme në nenin 6 paragrafi 4 dhe nenin 3 paragrafi 1, me nënparagrafin 1.6. Njëra dispozitë këtë përgjegjësi e përcakton të farmacistit përgjegjës ndërsa tjetra përgjegjësi të bartësit të licencës profesionale.

Propozimi 7 (Propozim i ri - mos pajtim me propozimin e grupit punues)

Në nënparagrafin 5 të nenit 6, pas shprehjes “është e ndaluar” të shtohet shprehja “që në mungesë të prezencës së farmacistit:”. Pjesa tjetër mbetet e njëjtë.

Arsyetim

Ligji për Shëndetësi nr. 04/L-120 në paragrafin 2 të Nenit 26,, lejon dispensimin e barnave nga ose në prezencë të farmacistit, prandaj formulimi i këtij nënparafi do të ishte në përputhje me këtë dispozitë të ligjit për shëndetësi.

Propozimi 8 (Propozim i ri)

Në nënparagrafin 6 të nenit 6, pas shprehjes “MSH” të shtohet “/OFK”

Arsyetim

Kompetencat mbi licencimin e profesionistëve shëndetësorë nga viti 2017 janë bartuar në kuadër të Odave të Profesionistëve Shëndetësor, prandaj në përputhje me këtë e konsiderojmë të domosdoshëm këtë plotësim.

Propozimi 9 (Propozim i ri)



Pas paragrafit 8 të nenit 6, të shtohet paragrafi i ri 9 me këtë përmbajtje *“Bartësi i licencës për barnatore me rastin e aplikimit për licencim deklaron ne AKPPM orarin e barnatores si dhe orarin farmacistit/tëve dhe personelit profesional sipas formularit për aplikim dhe konform ligjit të punës.*

Arsyetim

OFK e konsideron me rëndësi të veçantë deklarin e farmacistëve përgjegjës dhe orarin e tyre për të cilën janë përgjegjës, sepse nga praktika e deritanishme disa raste të shkeljeve ligjore kanë ndodhur në barnatore në orare në të cilat sipas kontratave nuk ka farmacist përgjegjës. Përfshirja e këtij propozimi do të lehtësonte shumë punën e inspektoreve farmaceutike dhe organeve për shqiptimin e masave disiplinore të OFK-së.

Propozim 10 (Propozim i ri – plotësim i propozimit të grupit punues)

Paragrafi 1 i nenit 7 të mbetet ashtu siq është në udhëzimin bazë.

Paragrafi 2 i nenit 7 të udhëzimit administrative bazë plotësohet dhe ndryshohet si në vijim :

“Aplikuesi obligohet të plotësoj në sistemin online të AKPPM-së “ Barnatari” aplikacionin duke bashkangjitur dokumentacionin përcjellës varësisht nga lloji i aplikimit të përcaktuar në mënyrë taksative në dispozitat e këtij udhëzimi dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi. “

Arsyetim

OFK konsideron se publikimi dhe perkatimi i formularëve paraprakisht me dispozitat ligjore dhe publikimi i tyre do të ndikonte në rritjen e transparencës dhe do të shmangte çfardo keqinformimi dhe keqinterpretimi si dhe do të shmangte mundësinë për interpretim të ndryshëm të aplikacioneve nëse ato nuk publikohen dhe përcaktohen paraprakisht

Propozimi 11 (Mos pajtim me propozimin e grupit punues)

Paragrafi 4 i nenit 7 të udhëzimit bazë të riformulohet si në vijim *“ AKPPM-ja është e obliguar që në afat prej 10 ditëve të punës nga dita e pranimit të aplikacionit t’i përgjigjet aplikuesit “*

Arsyetim



OFK vlerësin se afati i propozuar nga grupi punues prej 15 ditëve të punës, është afat i gjatë i cili në praktikë ka kosto shtesë të mëdha për bartësit e licencës profesionale të barnatores e cila efektivisht nënkupton të paktën 20 ditë kalendarike për të cilat të njëjtit do të jenë të detyruar të paguajnë shpenzimet për objektet dhe shpenzimet tjera përcjellëse, prandaj ne vlerësojmë se afati 10 ditorë do të ishte i mjaftueshëm për realizimin e detyrave.

Propozimi 12 (mos pajtim me propozimin e grupit punues)

Paragrafi 5 i nenit 7 të mbetet ashtu siq është në udhëzim bazë.

Arsyetim

Lëshimi i vendimit dhe arsyetimi i tij mbi shkaqet e refuzimit si dhe udhëzimi për përdorimin e mjetit juridik janë kërkesa esenciale që kërkohen për një akt administrativ të përcaktuar me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Propozimi 13 (pajtimi me propozimin e grupit punues)

OFK përkrah propozimin e grupit punues për pagesë të njëherëshme të licencës për 5 vite nëse aprovohet UA për tarifën e shërbimeve të AKPPM-së (tarifa 500 Euro për 5 vite të Licencës)

Propozimi 14 (pajtim-plotësim i propozimit të grupit punues)

Plotësohet dhe ndryshohet paragrafi 1 i nenit 8 të udhëzimit administrativ bazë si në vijim :
“Dokumentacioni i nevojshëm për t’iu bashkangjitur aplikacionit për licencim në sistemin online të AKPPM-së “ Barnatari”, i cili mund të shkarkohet edhe nga faqja e internetit është.”

Arsyetim

OFK konsideron se për një periudhë tranzitore duhet të shikohet mundësia që palët të kenë mundësi që aplikimet krahas Barnatarit të mund të bëhen edhe në prezencë fizike “Hard Copy”

Propozimi 15 (Propozim i ri)

Nënparagrafi 1.3 i paragrafi 1 të nenit 8 të riformulohet sipas kësaj përmbajtje . Licenca valide e punës e farmacistit përgjegjës e dhënë nga MSH/OFK



Arsyetim

Nga viti 2017 kompetencat mbi licencimin e profesionistëve shëndetësor janë bartur në kuadër të odave të profesionsitëve shëndetësor. Ne konsiderojmë të dosmosdoshme që pas gjdo dispozite ku kërkohet licencë të shtohet licencë valide për të shmangur cfardo kolizioni në interpretim

Propozimi 16 (Mospajtim me propozimin e grupit punues)

Nënparagrafi 1.5 i paragrafit të nenit 8 duhet të mbetet ashtu siq është tani “Kontrata e punës në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit”

Arsyetim

OFK konsideron se propozimi për noterizimin e kontratave është procedurë shtesë që ka kosto shtesë ekonomike dhe konsiderohet vetëm si burokraci e organeve. Prandaj qëndrojmë pranë asaj që kontratat të vlerësohen ashtu si deri më tani.

Propozimi 17 (Propozim i ri)

Pas propozimit për përfshirjen e nënparagrafit 1.8 shtohet një nënparaf i ri 1.9 me këtë përmbajtje “Përcaktimi i orarit të punës për farmacistin përgjegjës”

Arsyetim

OFK e konsideron me rëndësi të veçantë deklarinimin e farmacistëve përgjegjës dhe orarin e tyre për të cilën janë përgjegjës, sepse nga praktika e deritanishme disa raste të shkeljeve ligjore kanë ndodhur në barnatore në orare në të cilat sipas kontratave nuk ka farmacist përgjegjës. Përfshirja e këtij propozimi do të lehtësonte shumë punën e inspektoreve farmaceutike dhe organeve për shqiptimin e masave disiplinore të OFK-së.

Propozimi 18 (plotësim i propozimit të grupit punues)

Pas paragrafit 2 të nenit 9 të udhëzimit administrativ bazë shtohet një paragraph i ri me numër rendor 3 dhe nënparagraf të ri 3.1 **me tekstin** si në vijim:



“Aplikimi për rilicencim në sistemin online të AKPPM-së (Barnatari) duhet të bëhet 30 ditë para skadimit të licencës së veprimtarisë, në të kundërtën aplikuesi duhet t’iu nënshtrohet procedurave të licencimit sipas nenit 8 të udhëzimit administrativ.

3.1 AKPPM paralamëron në dy periudha kohore (60 ditë para skadimit dhe 45 ditë) bartësin e licencës dhe farmacistin përgjegjës për datën e skadimit të licencës profesionale të barnatores”

Arsyetim

OFK pajtohet me propozimin e grupit punues duke propozuar që ky propozim të plotësohet edhe me periudhën kohorë për të cilën AKPPM merr për detyrim paralajmërimin e bartësit të licencës dhe farmacistit përgjegjës për afatin e skadimit të licencës profesionale të barnatores

Propozimi 19 (Mos pajtim me propozimin e grupit punues)

OFK konsideron se propozimi i grupit punues “Pas nenit 9 të udhëzimit administrativ bazë shtohet një nen i ri me numër rendor 9A si në vijim:

Neni 9A

Vlerësimi për rilicencim

1. Procedura e vlerësimit për rilicencim aplikohet njëjt sikurse për licencim”

nuk duhet të përfshihet në këtë UA.

Arsyetim

OFK konsideron se ky propozim është propozim jo ligjorë për shkak se i njëjti cenon parimin e jo retroaktivitet të dispozitave ligjore, dhe cënon rëndë të drejtat e barnatoreve të cilat janë licencuar në përputhje me normat e përcaktuara në Udhëzimin 11/15.



Propozim i ri 20 (Propozim I ri – Gjobat)

Në nenin 16, pas paragrafit 5, shtohet paragrafi 6 me dy nënparagrafe si më poshtë

“1. Për recidivistët e shkeljeve të cilat në periudhen prej 2 viteve të operimit, përsërisin së paku 3 herë shkeljene e neneve 6 paragrafi 3 “barnatorja mund të funksionojë vetëm në prezencë të farmacistit” dhe shkeljet nga neni 12, paragrafi, 1, 2 dhe 3 , bartësi i licencës profesionale për barnatore I revokohet e drejta e ushtrimit të kësaj veprimtaria për 3 vite.

2. Për recidivistët e shkeljeve të cilat në periudhen prej 5 viteve të operimit, përsërisin së paku 4 herë shkeljene e neneve 6 paragrafi 3 “barnatorja mund të funksionojë vetëm në prezencë të farmacistit” dhe shkeljet nga neni 12, paragrafi, 1, 2 dhe 3 , bartësi i licencës profesionale për barnatore I revokohet e drejta e ushtrimit të kësaj veprimtaria për 5 vite.”

Arsyetim

Duke parë që gjobat e shiptuara nga neni 16 I UA bazë deri më tani nuk po tregojnë rezultatë në luftimin e këtyre dukurive negative për sektorin farmaceutik, e konsiderojme si të domosdoshme që në përputhje me paragrafi 4 të Nenit 37 të LIGJI NR. 04/L -190 PËR PRODUKTE DHE PAJISJE MEDICINALE të shqiptohet ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë profesionale të bartësit të licencës





ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komora Farmaceuta Kosova
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 318 Dt. 07/07/21

KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS (OFK), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.15 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150, nenit 20, paragrafi 18 të Statutit të Odës së Farmacistëve të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 26/06/2021, nxjerr këtë :

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** raporti financiar dhe llogaria përfundimtare e OFK-së për periudhen 1 Janar 2020 – 31 Dhjetor 2020.
- II. Raporti i miratuar i bashkangjitet këtij vendimi
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I'dërgohet:

- **Shërbimit Profesional të OFK-së**

Kryetari i OFK-së

Dr.sc. Arianit Jakupi





ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komora Farmaceuta Kosova
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 318 Dt 07/07/21

RAPORTI FINANCIAR

PËR PERIU DHËN JANAR_DHJETOR_2020

TE HYRAT	Realizimi ne €
Të hyrat nga MSH të përcaktuara me Statut dhe Ligj	
Të hyrat nga MSH-ja te arketuara pas 3 vjeqarit të themelimit të Odës	
te hyrat nga Aantaresia	75,276.00
Te hyrat nga Licencimi	10,170.00
Te hyrat nga Rilicencimi	5,200.60
Te hyrat nga pagesa e vertetimit te Kodit Etike	10.00
Te hyrate nga pjsmarrja ne seminare, konferenca vendore	1,620.00
Te hyrat nga mbatja e provimit te rilicencimit	2,800.00
Te hyrat nga dhenja e faksimilit	180.00
Te hyrat nga akreditimi	1,600.00
Te ardhurat nga sponsorimet	4,530.00
Te hyra te tjera	210.00
TE HYRAT NE TOTAL	101,596.60

SHPENZIMET (Pagat bruto dhe KPP)	Realizimi ne €
Pagat bruto, shpenzimet per meditje per kuvend dhe keshilla dhe komisione (është i perfshirë tatimi mbi pagë)	74,933.38
Kontributet Pensionale të Punëdhënësit	3,434.09
TOTALI I SHPENZIMEVE PER PAGA MEDITJE PER KUVEND , KESHILLA DHE KOMISIONE	78,367.47

SHPENZIMET TJERA OPERACIONALE	
Material shpenzues për zyrë	6,335.11
Shpenzimet e telefonit	106.30
Shpenzimet e internetit	119.94
Shpenzimet e antarsimeve	2,493.00
Shpenzimet e e internetit per Google Gsuite	110.51
Shpenzimet e derivateve	550.00
Shpenzimet per organizimin e konferences	3,258.50
Provizioni bankarë	482.91
Shpenzimet e reklames sherbime te sms	822.70
Shpenzimet e reprezentacionit	152.15
Shpenzimet per pergaditjen e projrktit te barnatores	1,900.00
Shpenzimet per mirëmbajtje te WEB-it	1,460.00
Shpenzimet per akomodim dhe udhetime zyrtare	1,783.08
TOTALI I SHPENZIMEVE OPERACIONALE	19,574.20

PERMBLEDHJA



SALDO ME 31.12.2019	69,292.69
TE HYRAT	101,596.60
GJITHESEJT TE HYRAT	170,889.29
GJITHESEJT SHPENZIMET	97,941.67
31.12.2020	72,947.62

Kryetari OFK-se

Arianit Jakupi

